

VENDIM
Nr. 49, datë 23.3.2022

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME VENDNDODHJE NË ZONËN E REMASIT – KARAVASTA, LUSHNJË DHE LIBOFSHË, FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 140 mw

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 13, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 382/1 prot., datë 17.3.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 261, datë 21.12.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mw.

- Me shkresën nr. 1129/2 prot., datë 30.12.2021, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s e po ashtu për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 10.1.2022, ora 14:00, për të sqaruar dokumentacionin e konstatuar si të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Në seancë është ftuar dhe OST sh.a., me qëllim sqarimin e fazës në të cilën ndodhet procedura për marrjen e miratimit përfundimtar të pikës së lidhjes së impiantit të shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. me rrjetin e transmetimit.

- Pas zhvillimit të seancës dëgjimore, shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. ka depozituar dokumentacion dhe informacion me shkresën e protokolluar në ERE nr. 48/2 prot., datë 27.1.2022.

- Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. nuk plotësonte tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 48/3 prot., datë 15.2.2022, duke i evidentuar dokumentet që mbeten pa u plotësuar tërësisht dhe/ose kanë nevojë për informacion shtesë. Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e afatit për pranimin ose refuzimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për aplikuesin rasti pas rasti, konkretisht:

“3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.”.

- Duke qenë se shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar nga Rregullorja, vlerësohet që të zgjatet me 30 (tridhjetë) ditë pune afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i dhënë kështu mundësinë shoqërisë që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa u plotësuar i cili duhet të depozitohet brenda 20 (njëzet) ditëve pune.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mw.

2. Shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve pune.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti